


	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	 PRISHTINA
--	--	--

Për: Shyqri Dumani , Lagja Kalabria, rruga Hasi nr.18

Nga : Drejtoria e Urbanizmit, Komuna e Prishtinës

Subjekti: Përgjigje për banorin e lagjes Shyqri Dumani

Data: 07.02.2025

Banori i lagjes ‘Kalabria’, Shyqri Dumani, ka kërkuar që të mos lëshohen “Leje ndërtimore” për ndërtime të lartë në bllokun B12/ZSHP sipas kërkesës 05-350/02-48111 dt. 12.04.2024, pasi që parcelat 7639-13 dhe 7639-15 Z.K Prishtinë, në emër të Salih Muqollit dhe Ekrem Muqollit janë në kontest gjyqësor. Gjithashtu ka kërkuar, që rruga e Hasit të mos përfshihet në ndërtim të lartë, pasi që në atë rrugë aderojnë shtëpitë në parcelat kadastrale 7639/4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Lidhur me kërkesën e parashtruar ju informojmë se parcelat kadastrale 7639-13 dhe 7639-15 Z.K Prishtinë, nuk përfshihen në bllokun urban B12/ZSHP. Ndërsa sa i përket rrugës së Hasit, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, gjatë miratimit të zgjidhjeve urbane dhe rrugëve që planifikohen brenda bllokut urban kujdeset që parcelat të qasen në ato rrugë, për të vazhduar më pas në rrugët publike. Kjo Drejtori në bazë të rregullativës, i zbaton Planet Rregulluese në fuqi. Në këtë rast do të veprojmë në bazë të kritereve të Planit Rregullues të Hollësishëm "Kalabria"2024-2032 miratuar me Vendimin 01 Nr. 350/01-75041/24 dt.10.06.2024 të Kuvendit të Komunës së Prishtinës të cilin plan mund ta gjeni në web-faqen e Komunës së Prishtinës. në linkun,

<https://prishtinaonline.com/drejtore/planifikim-strategjik/sektori-i-planifikimit-hapesinor/kalabria>